



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Dana

16-07-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:018816

Datë: 07.06.2018

Numri i dokumentit: 00056359

P.nr. 19/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja individuale Kadrije Goga-Lubishtani, me sekretaren juridike Florije Jakupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1169-6/16 të datës 16.12.2016, në prezntë të prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit [REDACTED], dhe përfaqësuesit juridik të dëmtuarit APK në Ferizaj- [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 29.05.2018, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

[REDACTED], i lindur me [REDACTED] në f. [REDACTED], Komuna e Ferizajt, ku edhe jeton, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 09.07.2016 rreth orës 15.10 në pyllin shoqëror të cilën e menaxhon Autoriteti pyjor Komunal-Ferizaj, në rajonin ekonomik-pyjor Nerdime-Jezerc në vendin e quajtur "Varret e krushqve", me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 3 copë dru të llojit ahu me dimensione të gjata boniteti III m., me diametër 53-70 cm., gjithsejtë në kubaturë prej 9.11 m. Kub, të cilat i ka bartur me traktor të tipit "Rakovic", vlera e dëmit të shkaktuar është 1229.75 €,

-me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,7,17,21,41,46,47 dhe 73 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së,

G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/ tre/muaj, konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 200 /dyqind/ €, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200 /dyqind/ Euro, të cilat dënime është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 /njëzet/ euro, një ditë burgu.

I akuzuari obligohet që të dëmtuarit APK- në Ferizaj, në emër të kompensimit të dëmit të paguaj shumën prej 1229.75 Euro, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari [REDACTED] që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20/ njëzetë euro /€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të

paguaj shumën prej nga 30 /tridhjetë/ €, të gjitha në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr. 1169-6/16 të dt.16.12.2016, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 22.05.2017 në të cilin Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptoi sanksion penal sipas ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ka ngarkuar aktakuza, mirëpo edhe pse ka qenë i njoftuar me të drejtat e tij se ka të drejt të ushtroj kërkesë për hedhje të akuzës dhe kundërshtimin e provave, i njëjti nuk ka bërë kërkesë të tillë.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 29.5.2018, ku pas njoftimit nga gjyqtari për të drejtën e tij që të deklarohet i fajshëm apo i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar: e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza, shprehi keqardhje dhe jam i penduar thellë, i premtoj Gjykatës në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, dhe e lut gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në shqyrtimin gjyqësor mbi bazën e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës e që vërtetohet dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si fletëparaqitja e rojës së pyllit e dt.12.07.2018, ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor, ndërsa si rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajësisë gjendjen e tij ekonomike dhe rrethanat familjare.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës APK-së Zyra në Ferizaj – [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka mbështetur fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit si dhe parashton kërkesën pasurore juridike në vlerën e cekur në dispozitave të aktakuzës.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës dhe nga fletëparaqitja e Autoritetit pyjor-Komunal në Ferizaj me nr. 304/2016 i datës 12.7.2016, fletëparaqitja e rojës së pyllit me nr. të ditarit 52/2016 e datës 12.7.2016, procesverbalit mbi vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga ana e të pandehurit.

- si dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

Vlerësuar nga aspekti juridik, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale i cili ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, meqë me datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri e ka pre dru në pyllin shoqëror në vendin e quajtur “Varret e Krushqve” dhe ata në kubaturë të përgjithshme prej 9.11m. kub dhe në vlerë prej 1229.75 Euro.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimin gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73, të KPRK-së, për të akuzuarin [REDAKTUAR] si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë, kurse si rrethana lehtësuese mori, gjendjen e varfër ekonomike, i ri në moshë, është mbajtës i familjes shtatë anëtarësh, e në mungesë të rrethanave rënduese, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave të pandehurit i vërtetoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 3/ tre/muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 200 /dyqind / €, me bindjen se në rastin konkret me dënimin e tillë do të arrihet qëllimi

ndëshkimor, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe me autorët të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 450 dhe 463par.2 të KPPK-së, Gjykata ka obliguar të akuzuarin që të kompensojë dëmin e shkaktuar Autoritetit pyjor komunal në Ferizaj në shumë prej 1229.75 Euro.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, Gjykata e ka obliguar të pandehurin [REDAKTUAR] në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20/ njëzetë euro /€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/ € në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.


Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.19/17, dt. 29.05.2018

Serketarja juridike,
F. Jakupi

Gjyqtari Individual
Kadrije Goga-Lubishtani



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.